



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 29.04.2024

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me datë 29.04.2024 në Durrës, nga ana e Njesisë së Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.3614/7 prot., datë 26.04.2024, me qëllim zbardhjen e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të kërkesave të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit ‘E Hapur’, me të dhënat si më poshtë vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Ushqime për QEA”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Kodi (CPV)15894210-6 - Ushqime për shkollë.

VLERA E FONDIT LIMIT: 39’994’302 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e dy) Lek pa TVSH.

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS**

Përllogaritja e vlerës së fondit limit:

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si edhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Vendimin nr.195, datë 22.12.2023 të Këshillit Bashkiak, Bashkia Durrës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesem 2024-2026 dhe detajimin e buxheti të Bashkisë Durrës për vitin 2024”.



Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe
- çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- a) çmimet e tregut; ose/dhe
- b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- c) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Në vijim të Urdhërit nr. 87 datë 19.03.2024 protokolluar Nr. 3614 prot., datë 19.03.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje ushqime per QEA”, grupi i punës, pasi u njoh me objektin e prokurimit, e filloi punën për hartimin e dokumentacionit duke pasqyruar në të dhe ndryshimet përkatëse.

Grupi i punës realizojë punë kërkimore mbi çmimet orientuese për mallrat, të cilat janë objekt prokurimi; duke u bazuar në Çmimet e Instatit, hetimin e tregut vendas si dhe kontratat e mëparshme, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, u testua tregu në subjektet me NIPT si më poshtë: *NIPT: K11507003S; NIPT: L11614001S; NIPT: J64103483H* si dhe çmimet e kontratave të mëparshme bazuar dhe në VKM-në 835, datë 30.11.2022 “Për miratimin e rregullores për kërkesat higjieno-sanitare të pishinave”. Në fund të procesit u siguruan çmimet e vlerësuar për mallin, objekt i këtij prokurimi. Pas përlllogaritjes së preventivit të hartuar nga grupi i punës, pas studimit të tregut, vlera e përgjithshme rezulton të jetë **39’994’302 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e dy) Lek pa TVSH.**

Në përfundim, pas hartimit të preventivit, për objektin e prokurimit me titull: “Blerje ushqime për QEA”

Komisioni bazuar në vlerën e preventivit vendosi që:

Vlera e fondit limit rezulton: **39’994’302 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e dy) Lek pa TVSH.**

Afati Kohor dhe Garancitë e Produkteve

Për realizimin e punës dhe zbatimin e kontratës afati do të jetë deri në përfundimin e sasisë furnizimi do të kryhet pas çdo kërkesë të QEA-së në magazinën e Qendres Ekonomike të Arsimit Durrës.

Afatet e lëvrimit: **deri në përfundimin e sasisë 365 ditë**

Afati i skadencës për ushqimet e paketuara (koloniale) të jetë jo më pak se 1 vit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit



publik” ndyshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuar, vendosur dhe perlloritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlloritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndyshuar.

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit , sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së, i ndryshuar, nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë, licencë sipas objektit të prokurimit:

- Licence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)
- Kategoria II ”Prodhim dhe/ose tregtimi i ushqimeve.
- Nënkatëgoria II.1.A. ”Prodhimi, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”
- Nënkatëgoria II.1.B ”Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”.

Liçensa duhet të jetë në emër të OE të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, Informacionit mbi Liçensat, si dhe referuar



Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar i Ushqimeve nr. 10181 prot., datë 19.11.2018.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39'000'000 lekë**.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me

anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.



Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, nenin 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15'000'000 lekë.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 40 pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është vendosur brenda kufirit të



vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të **deklarojë (me anë të një deklaratë), që merr përsipër transportin** e mallrave objekt prokurimi në vendin e dorëzimit të kontratës (në magazinën e QEA), brenda afatit të përcaktuar në Dokumentave Standarte të Tenderit për lëvrimin e mallit.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor në formulimin e këtij kriteri kërkon prej Operatorit Ekonomik (Përfaqësuesit të subjektit) një deklaratë me anë të së cilës deklaron se merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi deri në vendin e ekzekutimit të kontratës (në magazinën e QEA-së), pa përfshirë kosto shtesë për këtë shërbim.

Në bazë të nenit 40 pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur nje deklaratë.

2.3.3 Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë **2 (dy)** mjet transporti **ATV frigoriferik** dhe mjet transporti **ATP jo frigoriferik**, automjete për kryerjen e furnizimit të ushqimeve si bukë, fruta, perime, etj. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit. Në rastin e disponimit të mjetit me qira duhet të paraqes kontratën noteriale të qirasë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës të mjetit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr.10181 Prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5 germa “ç” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur bazuar në objektin e prokurimit, kriter i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë

personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

- Është kërkuar që operatori të disponoj transport ATV frigoriferik, për të garantuar transport të përshtatshme për ruajtjen e vlerave ushqimore të produkteve.
- Është kërkuar që operatori të disponoj transport ATP (jo frigoriferik), transporti i produkteve ushqimore të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare.

Këto kritere përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, jo më pak **se 4 punonjës** si më poshtë:

- a. Drejtues mjetei 2 (dy)
- b. Punëtorë të thjeshtë 2 (dy)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Për punonjësit e punësuar si drejtues mjetei leje drejtimi tipit B për secilin.
- Për punonjësit e punësuar punëtorë të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune përkatëse.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 2 drejtues mjetei, OE paraqet jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimore , brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 4 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët



ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Këto kritere përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të zërthimit të specifikimeve/preventivit dhe të grafikut të shpërndarjes, për arsye se furnizimi është ditor edhe në orë të përcaktuar për të gjithë institucionet e varësisë sipas grafikut si dhe shtrirjes së madhe gjeografike të këtyre institucioneve, sipas punonjesve të mesipërm

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një **deklaratë**, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore në fuqi.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik””Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.7 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi/prodhimi të **mishit të vicit** në pronësi/qira, ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregëtimit:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Akt miratim leje higjeno-sanitare*

Kur kemi kontratë bashkëpunimi dokumentet e mësipërm duhet t’i ketë edhe njësia e prodhimit dhe/ose tregëtimit.



Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar ligjit për tregtarët dhe njesitë e tregtimit si dhe rekomandimit të Agjensisë së prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimeve nr. 10181 prot. Date 19.11.2018, „Siç është parashikuar në specifikimet teknike mishit të viçit. Ky produkt (mish) do të konsumohet për fëmijët e Kopshteve dhe çerdheve. Në rastin kur operatori nuk disponon njësi të tregtimit të mishit të vicit por ka një kontratë bashkepunimi ose kontratë furnizimi me njësinë e tregtimit, njësia e tregëtimit duhet të disponojë dokumentacionet e kerkuara si Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit dhe akt miratim leje higjeno-santare.

2.3.8 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi/prodhim të **mishit të pulës** në pronësi/qira ose kontratë bashkepunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Akt miratim leje higjeno-sanitare*

Kur kemi kontratë bashkepunimi dokumentet e mësipërm duhet t'i ketë edhe njësia e prodhimit dhe/ose tregëtimit.

Argumentimi: Vendosija e këtyre kriterëve konsiston në faktin që, Qendra Ekonomike e Arsimit furnizon çdo ditë me mish të freskët pulë kopshte dhe çerdhe të qytetit. Autoriteti kontraktor e bën porosinë për mish pulë tek furnitori, çdo ditë, pasi ka llogaritur nevojat ditore. Për përmbushjen e këtyre kërkesave, kontraktori duhet të vërtetojë se i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për t'u përgjigjur kërkesave të Autoritetit Kontraktor, çdo ditë përpara sine dhe parametrat e kërkuar. Për nga natyra e produktit, furnizimi me mish është jetësor dhe shumë delikat. Për të siguruar vazhdimësi në e furnizimeve ditore, sasinë e kërkuar dhe për të garantuar që produkti të jetë Brenda të gjitha parametrave të kërkuar, ekzistenca e kompleksit është garanci. Kjo garanton faktin se operatori ekonomik ka mundësi të dhe kapacitetet furnizuese, duke vërtetuar kapacitetet e mbarështrimit dhe majmërimit të pulave. Në rastin kur operatori nuk disponon njësi të tregtimit të mishit të pulës por ka një kontratë bashkepunimi ose kontratë furnizimi me njësinë e tregtimit, njësia e tregëtimit duhet të disponojë dokumentacionet e kerkuara si Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit dhe akt miratim leje higjeno-santare.

2.3.9 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi/prodhim të **vezëve të pulës** në pronësi/qira ose kontratë bashkepunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*



- *Akt miratim leje higjeno-sanitare*

Kur kemi kontratë bashkëpunimi dokumentet e mësipërm duhet t'i ketë edhe njësia e prodhimit dhe/ose tregëtimit.

Argumentimi: Sasia totale e nevojave të parashikuar për vezë pule është e konisderueshme, Autoriteti kontraktor e bën porosinë për vezë pule tek furnitori, çdo ditë, pasi ka llogaritur nevojat ditore. Për përmbushjen e këtyre kërkesave, kontraktori duhet të vërtetojë se i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për t'iu përgjigjur kërkesave të Autoritetit Kontraktor, çdo ditë për sasinë dhe parametrat e kërkuar. Për nga natyra e produktit, furnizimi me vezë pule është parësore dhe shumë delikate. Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimeve ditore, sasinë e kërkuar dhe për të garantuar që produkti të jetë brenda të gjitha parametrave të kërkuar, ekzistenca e nje marrveshje apo kontrate apo akt pronësie është garanci. Kjo garanton faktin se operatori ekonomik i ka mundësitë dhe kapacitetet furnizuese. Ne rastin kur operatori nuk disponon njesi te tregtimit te vezeve te pules por ka nje kontrate bashkepunimi ose kontrate furnizimi me njësinë e tregtimit, njësia e tregëtimit duhet te disponoje dokumentacionet e kerkuara si Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimi dhe akt miratim leje higjeno-santare.

2.3.10 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi/prodhim të **qumështit, djathit, kosit, nënproduktet e tijë** në pronësi/qira ose kontratë bashkëpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Akt miratim leje higjeno-sanitare*

Kur kemi kontratë bashkëpunimi dokumentet e mësipërm duhet t'i ketë edhe njësia e prodhimit dhe/ose tregëtimit.

Argumentimi: Sasia totale e nevojave të parashikuar për qumeshtin dhe nen produktet e qumeshtit është e konisderueshme, Autoriteti kontraktor e bën porosinë tek furnitori, çdo ditë, pasi ka llogaritur nevojat ditore. Për përmbushjen e këtyre kërkesave, kontraktori duhet të vërtetojë se i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për t'iu përgjigjur kërkesave të Autoritetit Kontraktor, çdo ditë për sasinë dhe parametrat e kërkuar. Për nga natyra e produktit, furnizimi me produktet dhe nenproduktet e qumeshtit është parësore dhe shumë delikate. Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimeve ditore, sasinë e kërkuar dhe për të garantuar që produkti të jetë brenda të gjitha parametrave të kërkuar, ekzistenca e nje marrveshje apo kontrate apo akt pronësie është garanci. Kjo garanton faktin se operatori ekonomik i ka mundësitë dhe kapacitetet furnizuese. Ne rastin kur operatori nuk disponon njesi te tregtimit te qumeshtit djathit, kosit dhe nenproduktet e tije por ka nje kontrate bashkepunimi ose kontrate furnizimi me njësinë e



tregtimit, njësia e tregëtimit duhet te disponoje dokumentacionet e kerkuara si Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimi dhe akt miratim leje higjeno-santare.

2.3.11 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi/prodhim të **ushqimeve të amballazhuara (koloniale)** në pronësi/qira ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Akt miratim leje higjeno-sanitare*

Kur kemi kontratë bashkëpunimi dokumentet e mësipërm duhet t'i ketë edhe njësia e prodhimit dhe/ose tregëtimit.

Argumentimi: Vendorsja e ketyre kritereve konsiston ne faktij qe, Qendra Ekonomike e Arsimit furnizon kopshtet dhe çerdhet në qytet cdo ditë me ushqime koloniale si mjell, vaj, sheqer, makarona etj, pasi ka llogaritur nevojat ditore QEA. Kërkesa për Leje higjeno-sanitare është kërkuar për përcatimin e këtij kriteri komisioni i është referuar sasise së konsiderueshme të ushqimeve të planifikuar për tu furnizuar çdo ditë për furnizimin e çerdheve dhe kopshteve të Bashkisë së Durrësit. Ne rastin kur operatori nuk disponon njesi te tregtimit te ushqimeve te amballazhurara (koloniale) por ka nje kontrate bashkepunimi ose kontrate furnizimi me njësinë e tregtimit, njësia e tregëtimit duhet te disponoje dokumentacionet e kerkuara si Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimi dhe akt miratim leje higjeno-santare.

2.3.12 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi/prodhim të **tregtimi të frutave dhe zarzavateve** në pronësi/qira ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Kartë fermeri*
- *Akt miratim leje higjeno-sanitare*

Kur kemi kontratë bashkëpunimi dokumentet e mësipërm duhet t'i ketë edhe njësia e prodhimit dhe/ose tregëtimit.

Argumentimi: Në specifikimet teknike të produkteve është përcaktuar që ato kërkohen të jenë të freskëta. Ato nuk duhet të jenë të ruajtura në frigoriferë pasi qendra furnizohen me këto produkte 1 ditë para se ato të konsumohen. Kështu që frutat dhe zarzavatet duhet të jenë prodhime të freskëta dhe jo të magazinuara.



Kapacitetet e kërkuara të serrave, janë në përputhje me sasinë e konsiderueshme të nevojave për këto produkte të parashikuara në zbatim të kontratës. Ne rastin kur operatori nuk disponon njësi të tregtimit të frutave dhe zarzavateve por ka një kontratë bashkëpunimi ose kontratë furnizimi me njësinë e tregtimit, njësia e tregëtimit duhet të disponojë dokumentacionet e kërkuara si Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit dhe akt miratim leje higjeno-santare.

2.3.13 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi/prodhim **të bukës së grurit, integral dhe thekër**, në pronësi/qira ose kontratë bashkëpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimit:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

- Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.
- Akt miratim leje higjeno-sanitare

Kur kemi kontratë bashkëpunimi dokumentet e mësipërm duhet t'i ketë edhe njësia e prodhimit dhe/ose tregëtimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB, Leje Higjeno-Santare Për përcatimin e këtij kriteri komisioni i është referuar sasise së konsiderueshme të bukës të planifikuar për tu furnizuar çdo ditë. Plotësimi i këtij kriteri do të garantonte zbatimin me korrektesë të kontratës. Ne rastin kur operatori nuk disponon njësi të tregtimit të bukes integrale dhe theker por ka një kontratë bashkëpunimi ose kontratë furnizimi me njësinë e tregtimit, njësia e tregëtimit duhet të disponojë dokumentacionet e kërkuara si Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit dhe akt miratim leje higjeno-santare.

(Sqarim: Kjo kërkesë i referohet rekomandimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëar të Ushqimeve Nr. 10181 prot. Date 19.11.2018).

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë:

- Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, është vendosur në bazë të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e



Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.

2.4 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: “..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Për hartimin e specifikimeve teknike është patur parasysh, natyra e përdorimit të produkteve ushqimore si produkte ushqimor në përbërje të menusë së miratuar me Urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, dhe Urdhërit nr. 457, datë 13.06.2018, Për një ndryshim të Urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, Hartimi i specifikimeve teknike, nga ana e Komisionit, është kryer duke iu referuar:

- Standardeve Shtetërore në fuqi STASH, për çdo artikull.
- Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar,
- VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”,
- Udhëzimin nr. 5, datë 25.03.2011 “Për kërkesat specifike të higjenës për stabilimentet e prodhimit, grumbulimit dhe përpunimit të produkteve me bazë qumshti”,
- Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.
- Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”,
- Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,
- Udhëzimin nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645 datë 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014 Për miratimin e rregullores “Mbi



kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,
- Udhëzimin nr. 15, datë 09.09.2021 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “për Kriteret Mikrobiologjike për produktet ushqimore.

Shënim: Në rastet kur citohet në specifikimet teknike termi “Cilësia e parë”, ose “Cilësi e mirë” ky përcaktim është i barasvlefshëm me termin “ekuivalentë”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri	Bashkia Durrës
Adresa	Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks	052 22 23 10
E-mail	info@durres.gov.al
Ueb-faqe	www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, Mall

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-02947-04-29-2024

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje ushqime për QEA”

5. Fondi limit: 39’994’302 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e dy) Lek pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 365 ditë

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 15.05.2024, Ora: 10:00



Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anetaret e njesise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit

